



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Mars 2021

Nr: 160

VENDIM

**PËR SHOQRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E Z. PAL MARASH SHKAMBI SI
KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT, NË ZONËN ZGJEDHORE
QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga komiteti nismëtar për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 37, datë 05.02.2021 ka regjistruar komitetin nismëtar i cili do të organizojë punën për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për paraqitjen e z. Pal Marash Shkambi, si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Me shkresën nr. 863 prot., datë 03.02.2021, komiteti nismëtar ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nënshkrimet mbështetëse të 1816 zgjedhësve, për të cilët shprehet se janë të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër.



Data: 18 Mars 2021

Nr. 160

Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

Referuar ekstraktit më të fundit të listës së zgjedhësve rezulton se Qarku Shkodër ka 274.230 (dyqind e shtatëdhjetë e katërmijë e dyqind e tridhjetë) zgjedhës. Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 69, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, numri i zgjedhësve që i korrespondon kufirit minimal prej 1 për qind të listës së 274 230 zgjedhësve të zonës zgjedhore qarku Shkodër është 2 743 (dymijë e shtatëqind e dyzet e tre) zgjedhës.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.1030 prot., datë 09.02.2021 i ka kërkuar komitetit nismëtar dhe z. Pal Marash Shkambi korrigjimin për plotësim të dokumentacionit sipas pikës 3 të nenit 69, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Brenda afatit komiteti nismëtar ka depozituar dokumentacionin e korrigjuar përkatësisht ka depozituar 950 nënshkrime. Pra në total janë depozituar 2.766 nënshkrime.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, Qarku Shkodër; Model – 04;
2. Deklaratë e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë, ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkuron në zgjedhje, Model - 05;
3. Listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore që mbështesin kandidatin, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit;
4. Jetëshkrimi i kandidatit Model – 07;
5. Formulari i vetëdeklarimi;
6. Deklaratat e kandididatit të propozuar nga zgjedhësit i cili deklaron se ka hapur llogari të posaçme; Model – 03/1;

Në mbështetje të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7 të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ftoi komitetin nismëtar, për të qenë prezent në seancën publike për verifikimin e numrit të nënshkrimeve.

Neni 69 pika 3 përcakton se komiteti mund të regjistrojë një kandidat për deputet vetëm në rast se ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon jo më pak se 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por në çdo rast jo më shumë se 3000 (tre mijë) zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.



Administrata e KQZ-së verifikoi nënshkrimet e zgjedhësve në listat mbështetëse për qarkun Shkodër për të cilat rezultoi se gjithsej janë dorëzuar 2 766 (dymijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) nënshkrime të plotësuara. Për çdo zgjedhës në listë bashkëlidhur është depozituar dhe kopje e letërnjoftimit.

Në bazë të nenit 71, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nga administrata e KQZ-së është bërë verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar duke përzgjedhur në mënyrë rastësore 5% të zgjedhësve nga lista e zgjedhësve mbështetës. Numri i zgjedhësve të verifikuar është 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) zgjedhës.

Në përfundim, nga verifikimi i nënshkrimeve të depozituara nga zgjedhësit mbështetës rezulton se, numri i zgjedhësve që kanë nënshkruar në listën mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta është më i madh se numri minimal i kërkuar në bazë të nenit 69, pika 3 të Kodit Zgjedhor, për nënshkrimet.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit, nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kandidati i propozuar nga zgjedhësit për deputet, z. Pal Marash Shkambi ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër 007 unik, datë 10.02.2021, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Pal Marash Shkambi, rezulton se ka deklaruar :

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të formularit të vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjeneralitetet e tij dhe është shprehur se, ka ndryshuar datëlindjen nga “04.08.1963” në “24.08.1963”.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, **pikës 1** “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:
 - a. Në vitin 1982, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, akuzuar për veprën penale, *Përvetësim të Pasurisë Socialiste*, për motive politike, vepër penale për të cilën është dënuar me 2 (dy) vite burgim;

- b. Në vitin 1983, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, akuzuar për veprën penale, *Përvetësim të Pasurisë Socialiste*, për motive politike, vepër penale për të cilën është dënuar me 20 (njëzetë) muaj burgim;
- c. Në vitin 2006, është dënuar nga Gjykata e Manastirit Maqedoni, akuzuar për veprën penale, *Prishje e rendit publik me motiv mbrojtjen e të drejtave të një vajze shqiptare*, për motive politike, vepër penale për të cilën është dënuar me 2 (dy) vite burgim.
- ç. Me vendimin nr. 153 (2066), datë 15.05.2013, është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprën penale *“Kundërshtim i punonjësve që kryejnë një detyrë shtetërore”*, parashikuar nga neni 235/1 i Kodit Penal, vepër penale për të cilën është vendosur masa e dënimit 100.000 (njëqind mijë) lekë gjobë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, paragrafi 2, shkronja "b" dhe paragrafi 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1249 prot., datë 16.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1248 prot., datë 16.02.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet e propozuar nga zgjedhësit, z. Pal Marash Shkambi, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Për sa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Në këto kushte me shkresën nr. 1615 prot., datë 02.03.2021, me lëndë kërkesë për verifikim më të thelluar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Koordinimit Institucional, Sektorit të Dekriminalizimit, për verifikim të plotë të kandidatit për deputet të propozuar nga zgjedhësit, z. Pal Marash Shkambi.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 1683/1 prot., datë 19.02.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet të propozuar nga zgjedhësit, z. Pal Marash Shkambi, i cili rezulton se ka shënime në sistem. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. 17 prot., datë 18.02.2021, rezulton se z. Pal Marash Shkambi,



1. Me vendimin nr. 131 datë 10.06.1982, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale të përvetësimit të pasurisë socialiste dhe në bazë të nenit 63 të Kodit Penal e dënon me 2 (dy) vjet heqje lirie.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

2. Në bazë të vendimit nr. 153 datë 15.05.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është deklaruar fajtor për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik dhe në bazë të nenit 235 të Kodit Penal dënohet me 100.000 (njëqind mijë) lekë gjobë.

Rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar deklaramëve të kandidatit për deputet të propozuar nga zgjedhësit, **z. Pal Marash Shkambi** si dhe përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vërehet se veprat penale për të cilat është deklaruar fajtor kandidatit për deputet të propozuar nga zgjedhësit për zonën zgjedhore qarku Shkodër, nuk përfshihen në sferën e ndalimeve të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Referuar të dhënave të disponuara të kandidatit nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 667/1 prot., datë 11.03.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjeneraliteteve të kandidatit për deputet të propozuar nga zgjedhësit z. Pal Marash Shkambi, sipas të cilës rezultoi se nuk ka kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Prokuroria e Përgjithshme, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet të propozuar nga zgjedhësit z. Pal Marash Shkambi.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 69, 72 e 73 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 69, 71, 72 e 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, dhe të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,



V E N D O S :

1. Të regjistroj z. Pal Marash Shkambi, si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 18 Mars 2021
Nr. 160

Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Pal Marash Shkambi si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021